



eptisa

PROJECT IMPLEMENTED BY JV NTU/EPTISA



FINANCED BY GOA AND COFINANCED BY WB



WORLD BANK GROUP

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Projekti i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate

Hua e Bankës Botërore Nr. 8489-AL

Nr. i Kontratës: CS02

Shërbime Konsulence

për

Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore

Raporti i Zhvillimit të Kapacitetit dhe Trajnimit të Palëve të Interesit

D-3.5 Shtojca 2

Versioni Paraprak

Prill 2021



TË DHËNAT IDENTIFIKUESE TË PROJEKTIT

Emri i Projektit:	Shërbime Konsulente për Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore nën Projektin për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë Rrugore bazuar në Rezultate (RRMSP) për Rrjetin Rrugor Kombëtar
Numri i Referencës së Kontratës së Projektit:	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL
Shteti:	Shqipëria
Konsulenti:	JV NTU International A/S / EPTISA Servicios De Ingenieria S.L.
Adresa:	Vestre Havnepromenade 5, 4. Floor DK-9000 Aalborg Denmark
Telefoni:	+45 99 30 0000
Fax:	+45 99 30 0001
Personi kontakti:	Dritan Dibra – Menaxheri i Projektit, Eptisa
E-mail:	ddibra@eptisa.com
Data e Raportit:	Prill 2021
Autorët e raportit:	Antonino Tripodi, K-6 Specialist Ndërkombëtar për të Dhënat e Aksidenteve Florin-Marius Dumitru, K-7 IT Specialist i Manaxhimit të Projekteve Blerina Kurti, NK-5 Specialiste Lokale për të Dhënat e Aksidenteve Renato Kurti, NK-6 IT Specialist Lokal i Manaxhimit të Projekteve Arben Myrtaj, NK-7 Specialist të Dhënash <i>Me kontribut të:</i> Stelios Efsthadiadis, K-1 Specialist në Menaxhimin e Sigurisë Rrugore – Drejtues i Ekipit të Ekspertëve

SQARIM

"Ky raport (duke përfshirë çdo shtojcë dhe aneks bashkëngjitur) është përgatitur për përdorim ekskluziv dhe përfitim të Qeverisë së Shqipërisë / Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Bankës Botërore, dhe vetëm për qëllimin për të cilin është hartuar. Në qoftë se JVNTU / EPTISA nuk shpreh pëlqimin paraprak me shkrim, asnjë pjesë e këtij raporti nuk duhet të riprodhohet, shpërndahet ose komunikohet tek ndonjë palë e tretë. JV NTU / EPTISA nuk pranon asnjë përgjegjësi nëse ky raport përdoret për një qëllim alternativ nga i cili është menduar, ose nga ndonjë palë e tretë"

KONTROLLI I DOKUMENTIT

Numri i Referencës së Kontratës së Projektit:	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL Shërbime Konsulente për Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore nën Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate (RRMSP)
Vendi	Shqipëria
Data	30.04.2021
Versioni	N°02

Versioni	Data	Pergatitur nga	Rishikuar nga
N°01	30.04.2021	Antonino Tripodi	Dragan Kostadinov Drejtor Projekti

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky dokument përbën rezultatet e Detyrës 3.2 të Komponentit 3 të Asistencës Teknike të Sigurisë Rrugore (AT) nën Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore të Bazuar në Rezultate (RRSMP).

Ndër të tjera, Komponenti 3 "Sistemi i Analizës së të Dhënave dhe Aksidenteve në Rrugë" ka për qëllim të trajtojë palët e interesuara locale në përdorimin e mjeteve dhe procedurave proactive për mbledhjen dhe analizën e të dhënave të aksidenteve në trafikun rrugor.

Një séance trajnimi në mbledhjen dhe analizën e të dhënave është organizuar përmes telekonferencës, më 17 dhe 18 Mars 2021. Trajnimi është vlerësuar bazuar në reagimet e marra nga palët e interesuara.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	5
1.1 Konteksti i përgjithshëm i projektit dhe qasja konsultative	5
2. Vlerësimi i Kursit të Trajnimit	5
2.1 Rezultatet e vlerësimit të seancave të trajnimit.....	6
Aneks A – Formulari i vlerësimit	10

LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE

AADT	Trafiku Mesatar Ditor Vjetor
ADF	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
AE	Zbatim i Automatizuar
ANPR	Njohja e Automatizuar e Targave
ARA	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ARC	Kodi Rrugor Shqiptar
ASP	Policia e Shtetit Shqiptar
ATC	Matje Automatikë e Trafikut
ATP	Policia Shqiptare e Trafikut
CBMIE	Departamenti Drejtues në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
CSG	Grupi Drejtues Qendror
DRST	Drejtoria e Trafikut dhe Sigurisë Rrugore
EC	Komisioni Evropian
EG	Grupi i Ekspertëve në Nivel Lokal
ERA	Reagimi i Urgjencës në Shqipëri
EU	Bashkimi Evropian
GDRTS	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
GoA	Qeveria e Shqipërisë
GRD	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
IMRSC	Komiteti Ndër-Ministror i Sigurisë Rrugore
INSTAT	Instituti i Statistikave
IoT	Instituti i Transporteve
ITS	Sistemi Inteligent i Trafikut
JV	Sipërmarrje e Përbashkët
M&E	Monitorimi dhe Vlerësimi
MI	Ministria e Brendshme
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
NGO	Organizatë Jo-Qeveritare
NSM	Menaxhimi i Sigurisë së Rrjetit
PAMECA	Misioni i Komunitetit Evropian i Ndihmës Policore për Shqipërinë
PIARC	Shoqata Ndërkombëtare e Rrugëve
QKUM	Qendra Mjekësore Kombëtare e Urgjencave
RSM	Menaxhimi i Sigurisë Rrugore
WB	Banka Botërore
WHO	Organizata Botërore e Shëndetësisë
AADT	Trafiku Mesatar Ditor Vjetor
ADF	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
AE	Zbatim i Automatizuar
ANPR	Njohja e Automatizuar e Targave
ARA	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ARC	Kodi Rrugor Shqiptar
ASP	Policia e Shtetit Shqiptar
ATC	Matje Automatikë e Trafikut
ATP	Policia Shqiptare e Trafikut

CBMIE	Departamenti Drejtues në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
CSG	Grupi Drejtues Qendror
DRST	Drejtoria e Trafikut dhe Sigurisë Rrugore
EC	Komisioni Evropian
ERA	Reagimi i Urgjencës në Shqipëri
EU	Bashkimi Evropian

1. Hyrje

1.1 Konteksti i përgjithshëm i projektit dhe qasja konsultative

Ky dokument përbën rezultatet e Detyrës 3.2 të Komponentit 3 të Asistencës Teknike të Sigurisë Rrugore (AT) nën Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore të Bazuar në Rezultate (RRSMP).

Ndër të tjera, Komponenti 3 "Sistemi i Analizës së të Dhënave dhe Aksidenteve në Rrugë" ka për qëllim të:

- *Trajnojë stafin e agjensisë (MIE dhe ARRSH) në teknikat diagnostike dhe aplikimet e sistemit, dhe stafin e policisë si dhe personelin shëndetësor në kërkesat themelore të futjes së të dhënave.*

Në veçanti, nga Konsulentit u kërkuar të zhvillonte një trajnim teorik dhe praktik mbi mbledhjen dhe analizën e të dhënave të aksidenteve të trafikut rrugor, në mënyrë koherente me planin konceptues për zhvillimin e një baze të re të të dhënave kombëtare dhe sistemit të informacionit të trafikut rrugor.

Temat e trajnimit janë zhvilluar bazuar në vlerësimin e nevojave të palëve të interesuara, të cilat tregojnë qartë, si nevojë kryesore, për t'u përqëndruar në analizën e të dhënave të aksidenteve. Grumbullimi i të dhënave të aksidenteve (veçanërisht për oficerët e Policisë Rrugore) u konsiderua gjithashtu i rëndësishëm në funksion të zbatimit të një forme të azhurnuar të mbledhjes së të dhënave, në përputhje me kërkesat e CADaS.

Kursi i trajnimit u zhvillua përmes teleconferencës më 17 dhe 18 Mars 2021.

Detaje rreth kursit të trajnimit mund të gjenden në Shtojcën 1 të Detyrës 3.5.

2. Vlerësimi i Seancës së Trajnimit

Seanca e trajnimit u ndoq nga 27 aktorë të interesuar nga Institucione të ndryshme Shqiptare (Policia Rrugore, ARRSH, Ministria e Transportit, etj.).

Të gjithë trajnuesit morën pjesë aktivisht në aktivitetet e trajnimit.

Dita 1 e trajnimit ishte kryesisht teorike, duke përshkruar komponentë të ndryshëm të një sistemi të mbledhjes, menaxhimit dhe analizës së të dhënave të trafikut rrugor, dhe duke u përqëndruar veçanërisht në shpjegimin e rëndësisë së qasjeve të bazuara në prova për sigurinë rrugore.

Sistemi i mbledhjes, menaxhimit dhe analizës së të dhënave të trafikut rrugor i zhvilluar për Shqipërinë gjatë detyrave të mëparshme të Komponentit është përdorur si referencë kryesore gjatë të gjitha aktivitetëve të trajnimit.

Dita 2 e trajnimit ishte më praktike. Meqenëse trajnimi është bërë praktikisht, ushtrimet praktike janë zëvendësuar me shembuj të drejtpërdrejtë të:

- Mbledhja e të dhënave.
- Analiza e të dhënave.
- Identifikimi i faktorëve të përplasjes së trafikut rrugor bazuar në të dhëna.

Gjatë trajnimit janë trajtuar tema specifike se si të përmirësohen më tej format e mbledhjes së të dhënave të aksidenteve në trafikun rrugor shqiptar dhe sistemi i menaxhimit të të dhënave të aksidenteve.

Një Formular i Vlerësimit të Trajnimit u hartua dhe iu dorëzua trajnuesve (shih Shtojcën 1). Rezultatet janë përmbledhur në tabelën vijuese. Rezultatet jepen në një shkallë nga 1 në 5, ku:

- "1" do të thotë që i anketuari nuk pajtohet plotësisht me deklaratën e propozuar. Në këtë rast vlerësimi ishte shënuar "Jo i kënaqshëm".
- "2" do të thotë që i anketuari nuk pajtohet me deklaratën e propozuar. Në këtë rast vlerësimi ishte shënuar "Jo i kënaqshëm".
- "3" do të thotë që i anketuari është neutral me deklaratën e propozuar. Në këtë rast vlerësimi u shënuar "I kënaqshëm".
- "4" do të thotë që i anketuari pajtohet me deklaratën e propozuar. Në këtë rast vlerësimi ishte shënuar "Mirë".
- "5" do të thotë që i anketuari pajtohet fuqimisht me deklaratën e propozuar. Në këtë rast vlerësimi ishte shënuar "Shumë mirë".

Shumica e pjesëmarrësve e vlerësuan trajnimin pozitivisht.

2.1 Rezultatet e vlerësimit të seancave të trajnimit


Mbi 90% e pjesëmarrësve në seancat e trajnimit plotësuan formularin e vlerësimit të përgatitur nga ekipi i ekspertëve të Konsulentit. Formulari i vlerësimit u shpërnda në secilën seancë trajnimi. Rezultatet e vlerësimit janë paraqitur të përmbledhura sipas temës së seancës së trajnimit për një analizë më të qëndrueshme.

Vlerësimi synonte të maste kënaqësinë e pjesëmarrësve me seancat e trajnimit, perceptimet e tyre mbi dobinë e trajnimeve në vendin e punës, rëndësinë e secilës temë të trajtuar nga seancat e trajnimit dhe cilësinë e aspekteve organizative.

Formulari i vlerësimit u shpërnda përmes një linku në internet. Ai ishte anonim dhe pjesëmarrësit u informuan mbi anonimitetin dhe konfidencialitetin e përgjigjeve të tyre.

Seancat e trajnimit u vlerësuan shumë nga pjesëmarrësit dhe u konsideruan shumë të dobishme për punën e tyre të përditshme. Sipas Grafikut 1, seancat e trajnimit u vlerësuan me 9.4, mesatarisht, në një shkallë nga 1 në 10, ku rreth dy të tretat (62%) e pjesëmarrësve zgjodhën numrin 10 (shumë i kënaqur) për të vlerësuar pjesëmarrjen e tyre në to. Po kështu, dobia e seancave të trajnimit për pjesëmarrësit mbi punën e përditshme ishte 9.4, mesatarisht, në një shkallë nga 1 në 10, dhe dy të tretat e pjesëmarrësve zgjodhën numrin 10 (shumë të dobishëm) për informacionin që morën përmes këtyre seancave trajnuese.

Grafiku 1. Vlerësimi i përgjithshëm i seancave të trajnimit




Burimi i të dhënave: Analiza e Konsulentit bazuar në formularin e vlerësimit të kryer nën Komponentin 4

Pothuajse të gjitha seancat e trajnimit, pavarësisht nga tema, u konsideruan shumë të rëndësishme nga pjesëmarrësit, të cilët i vlerësuan me rreth 4.7, mesatarisht, në një shkallë nga 1 (jo të rëndësishme) në 5 (shumë të rëndësishme).

Sipas të dhënave të paraqitura në Grafikon 2:

- 7 ndër 10 pjesëmarrës i konsideruan shumë të rëndësishme (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) seancat e trajnimit në lidhje me Inxhinierinë e Sigurisë Rrugore.
- 71% e pjesëmarrësve i konsideruan shumë të rëndësishme (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) seancat e trajnimit në lidhje me Analizën e të Dhënave të Aksidenteve të Trafikut Rrugor.
- 69% e pjesëmarrësve i konsideruan shumë të rëndësishme (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) seancat e trajnimit në lidhje me Monitorimin dhe Vlerësimin e Sigurisë Rrugore.
- Dy të tretat e pjesëmarrësve (67%) i konsideruan shumë të rëndësishme (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) seancat e trajnimit në lidhje me Menaxhimin e Sigurisë Rrugore, Legjislacionin, Financimin dhe Alokimin e Buxhetit.
- 64% e pjesëmarrësve i konsideruan shumë të rëndësishme (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) seancat e trajnimit në lidhje me Fushatat e Reklamimit dhe Ndërgjegjësimin të Sigurisë Rrugore dhe kryerjes së sondazheve për identifikimin e sjelljeve me rrezik të lartë të përdoruesve të rrugës.

Grafiku 2. Perceptimet mbi rëndësinë e seancave të trajnimit sipas temave




Burimi i të dhënave: Analiza e Konsulentit bazuar në formularin e vlerësimit të kryer nën Komponentin 4

Pavarësisht kushteve të veçanta të paraqitura nga pandemia, mënyra se si u organizuan seancat trajnuese i përmbushi pritshmëritë e pjesëmarrësve. Aspektet e lidhura me organizimin e seancave të trajnimit si përmbajtja, organizimi, kohëzgjatja dhe përkthimi i seancave të trajnimit, të cilat u vlerësuan nga pjesëmarrësit, u konsideruan si shumë të mira, me 4.7, mesatarisht, në një shkallë nga 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë mirë).

Rezultatet e vlerësimit treguan se (shih Grafikon 3):

- 77% e pjesëmarrësve e konsideruan shumë të mirë (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) përkthimin e ofruar gjatë seancave të trajnimit.
- 73% e pjesëmarrësve thanë se mënyra e zhvillimit të seancave trajnuese dhe përmbajtja e seancave të trajnimit ishin shumë të mira (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5).
- 62% e pjesëmarrësve e konsideruan shumë të mirë (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) kohëzgjatjen e secilës seancë trajnimit.

Grafiku 3. Perceptimet mbi cilësinë e aspekteve organizative



Burimi i të dhënave: Analiza e Konsulentit bazuar në formularin e vlerësimit të kryer nën Komponentin 4

Vlen të nënvizohet se asnjë pjesëmarrës nuk zgjodhi të vlerësojë më pak se mesatarja, më pak se 5 pikë nga 10, ose më pak se 3 pikë nga 5, aspektet nën shqyrtim, siç është e paraqitur në të dhënave më lart.

Aneks A – Formulari i vlerësimit